



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 12
Prishtinë, më 6.7.2021, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Arta Bajraliu, Mirlinda Sadiku, Eman Rrahmani, Fadil Nura, Enver Haliti, Yllza Hoti, Albana Bytyçi dhe Hajdar Beqa.

Munguan: Hykmete Bajrami, Bekim Arifi dhe Jasmina Dediq.

Stafi mbështetës i komisionit: Mehmet Simnica dhe Fatlind Azizi.

Të ftuar: znj. Rozeta Hajdari, ministre e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Nazif Asllani, u.d. kryeshef dhe Mentor Ugzmaili nga KRU “Bifurkacioni”; Arvita Zyferi, Enver Boqolli, Fitim Haliti, Ganimete Dalloshi Hoxhaj, Florim Beqiri nga ZKA-ja; *kryetari i Bordit dhe kryeshefi ekzekutiv i NPL “Hortikultura” (munguan).*

Pjesëmarrësit tjerë: Violeta Smajlaj nga ZKA-ja; Zyrafete Shala nga MINT; Leonora Bajrami nga KDI; Luljeta Tahiraj nga Kuvendi i Kosovës; Gëzime Shahini, Bekim Gashi, Egzona Tërdenci nga GP-LVV; Aulona Sylaj nga “Ekonomiaonline”; Ismail Shabani nga “Kosovapress”.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.6.2021;
3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë të Tregtisë dhe Industrisë për vitin 2020. Të ftuar, ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, znj. Rozeta Hajdari;
4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Kompanisë Rajonale “Bifurkacioni” për vitin 2020. Të ftuar, kryetari i Bordit dhe u.d. kryeshefi ekzekutiv;
5. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ndërmarrjes Publike Lokale “Hortikultura” sh.a. për vitin 2020. Të ftuar, kryetari i Bordit dhe kryeshefi ekzekutiv;

6. Të ndryshme.

Mbledhjen e kryesoi Arta Bajraliu, nënkryetare e parë e komisionit, e cila pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime. Pika e tretë e rendit të ditës kaloi në pikën e pestë të rendit të ditës, për shkak të angazhimeve të ministres, znj. Rozeta Hajdari. Ndërkaq, deputeti Enver Haliti propozoi shtimin e një pike të rendit të ditës: “Rekomandim/kërkesë për Zyrën Kombëtare të Auditimit, për të audituar projektin “Bashkimi i Qytetit” në Komunën e Ferizajt”, si pika e parafundit, para pikës “Të ndryshme”. Me 5 (pesë) vota për dhe 3 (tre) kundër, rendi i ditës u miratua si vijon:

1. *Miratimi i rendit të ditës;*
2. *Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.6.2021;*
3. *Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Kompanisë Rajonale “Bifurkacioni” për vitin 2020. Të ftuar, u.d. kryeshefi ekzekutiv dhe zyrtari i financave;*
4. *Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë të Tregtisë dhe Industrisë për vitin 2020. E ftuar, ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, znj. Rozeta Hajdari;*
5. *Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ndërmarrjes Publike Lokale “Hortikultura” sh.a. për vitin 2020. Të ftuar, kryetari i Bordit dhe kryeshefi ekzekutiv;*
6. *“Rekomandim/kërkesë për Zyrën Kombëtare të Auditimit, për të audituar projektin “Bashkimi i Qytetit” në Komunën e Ferizajt;*
7. *Të ndryshme.*

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.6.2021

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 29.6.2021, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Kompanisë Rajonale “Bifurkacioni” për vitin 2020

Kryesuesja, tha se ZKA ka audituar pasqyrat financiare vjetore të Kompanisë Rajonale të Ujit “Bifurkacioni”, të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2020, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020. Për më tepër, ajo ia kaloi fjalën deputetit raportues Enver Haliti.

Enver Haliti, tha se sot kemi në shqyrtim raportin për pasqyrat financiare vjetore të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës dhe Kanalizimit “Bifurkacioni”, që ka të bëjë kryesisht me auditimin e këtyre pasqyrave, si në aspektin financiar dhe pajtueshmërisë, i cili është i obligueshëm me ligj. Qëllimi i auditimit ishte dhënia e opinionit për PVF-të dhe konkluzion mbi pajtueshmërinë, në qoftë se PVF-të janë përgatitur dhe prezantojnë një pamje të drejtë

dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Opinioni i auditimit për KRU “Bifurkacioni” për vitin 2020, është opinion i kundërt. Auditori ka krijuar bazën e këtij opinion i për arsyt si në vijim: Kompania kishte prezantuar zërin e pronës, pajisjeve dhe impianteve në pasqyrën e pozitës financiare me vlerë neto 7,135,757€. Mirëpo, në 41 raste nga 70 mostrat e testuara, vlera neto e tyre në total ishte mbivlerësuar për 124,790€. Pika e dytë, bazuar në raportin e konsumatorëve për falje të borxheve që kishin përfituar nga Ligji për faljen e borxheve publike, 542 konsumatorë kishin dështuar që të përmbushin kushtet e marrëveshjes kontraktuale për pagesën dhe programimin e shlyerjes së borxhit në vlerë prej 202,126€. Kompania nuk kishte ndërmarrë veprime për të kthyer në listën e borxheve vlerën totale të borxhit 369,959€. Nën tre, kompania gjatë vitit 2020 kishte njohur të hyra nga arkëtimet e borxheve të provizionura në vlerë 31,076€, megjithatë nuk kishte ndonjë evidencë se cilëve konsumatorë u janë provizionuar më parë këto borxhe. Kjo për shkak se provizionimi ishte bërë në totalin e llogarive të arkëtueshme, duke mos identifikuar secilin konsumatorë. Nën katër, kompania kishte zvogëluar saldon e llogarive të arkëtueshme në totalin prej 396,392€, si rezultat i lejimit nga ATK që ndërmarrjet publike të deklarojnë dhe paguajnë TVSH-në në inkasim e jo në faturim. Megjithatë, nuk ishin identifikuar konsumatorët të cilët kanë qenë të liruar nga TVSH-ja për periudhën 2009-2015, në mënyrë që t’i zvogëlojë borxhet që ua ka faturuar gjatë kësaj periudhe. Nën pesë, kompania, procesin e vlerësimit të pasurive për herë të fundit e kishte realizuar në vitin 2007. Si rezultat i kësaj, në regjistrin kontabël figurojnë një numër i pasurive (510), me kosto historike në shumën 947,319€ e që janë të zhvlerësuar në tërësi, pra me vlerë neto në libra (0) zero. Kjo e gjetur është e përsëritur nga viti 2019. Nën gjashtë, kompania kishte hartuar pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, mirëpo për shkak të çështjeve të ngritura në lidhje me të hyrat jo operative, llogaritë e arkëtueshme, mungesën e dëshmive për grantet dhe çështjeve të tjera që kanë ndikim në rezultatin financiar në pasqyrën e të ardhurave. Fitimi i periudhës dhe informacionet tjera të bartura në pasqyrën e rrjedhjes së parasë dhe atë të ndryshimeve në ekuitet, nuk janë të sakta. Nën shtatë, kompania kishte përpiluar shënimet shpjeguese si pjesë përbërëse e pasqyrave financiare, megjithatë informacioni i dhënë nga kompania në shënimet shpjeguese është i mangët në lidhje me politikën kontabël të matjes së stoqeve, vlerën kontabël të stoqeve sipas klasifikimeve më të përshtatshme, si dhe vlerën e stoqeve të njohura si shpenzime të periudhës kontabël. Ndërsa, te konkluzioni për pajtueshmëri, kompania nuk kishte bërë harmonizimin në mes të regjistrit të pasurive dhe raportit të komisionit për inventarizim. Për 16 pasuri me vlerë neto 727,604€, të cilat në regjistrin e tyre kishin emërtimin “Nuk ka shënime për DN dhe Prod” nuk ka të dhëna në raportin e inventarizimit. Nën dy, sipas librave kontabël dhe pasqyrave financiare, vlera e stokut ishte prezantuar 190,464€, për të cilat nuk është bërë harmonizimi me gjendjet e stokut. Për më tepër, janë identifikuar mangësi në procesin e verifikimit të tyre. Ndërsa, çështje të tjera janë mungesa e dokumenteve burimore të llogarive të pagueshme tregtare, moslidhja e kontratave me secilin konsumator që merr shërbimet e ujit. Testimet tregojnë se nga 70 mostra të testuara në 58 raste, kompania nuk kishte lidhur kontratë me konsumatorët e saj për shërbimet që ofron, ku përcaktohen kushtet e përgjithshme sipas të cilave do t’u ofrohen shërbimet konsumatorëve.

Mospërfshirja e të gjitha prokurimeve në planin përfundimtar vjetor të prokurimit dhe mosdetajimi i planit, mosemërimi i zyrtarit për certifikimin e pagesave, që është e gjetur e përsëritur edhe nga viti i kaluar. Ndarja e tenderëve për furnizime/shërbime të njëjta/ndërlidhura, rastet e tilla janë: Tri kontrata për furnizim me pompa drenazhi dhe pompa elektromotorë, në vlerë të përbashkët 2,665€; tri kontrata për furnizim me inventar, në vlerë

të përbashkët 2,798€; gjashtë kontrata për riparime të automjeteve, në vlerë të përbashkët 4,740€; dy kontrata për sigurimin e automjeteve, kontrollimin teknik dhe regjistrimin e automjeteve, në vlerë të përbashkët 14,210€; katër kontrata për furnizim me klor të gaztë dhe klor të lëngët, në vlerë të përbashkët 9,816 € dhe dy kontrata për furnizim me lëndë djegëse për ngrohjen e objekteve, në vlerë të përbashkët 2,580€. Çështje tjetër është pozita aktuale të punës jo të parapara me organogram dhe rregullore, kompensimi i Bordit të Drejtorëve, në kundërshtim me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2020, Bordi i Drejtorëve, në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve, ishte kompensuar me pagë shtesë në baza mujore për 11 muaj në emër të komisionit të ashtuquajtur për hulumtim dhe zhvillim, në vlerën totale prej 4,730€. Ky kompensim nuk është në pajtim me vendimin e Qeverisë dhe me Ligjin për ndërmarrjet publike. Çështje tjetër është kriteri i përcaktuar në konkurs jo në përputhje me kriterin e rregullores së brendshme. Plani vjetor i auditimit të brendshëm nuk ishte i bazuar, në rrezik departamenti i auditimit të brendshëm, i cili përbëhet nga një zyrtar i auditimit, që kishte hartuar një plan vjetor për auditimet e vitit 2020, ku kishte paraparë vetëm dy auditime, pasi që zyrtarja planifikonte pushimin e lehonisë. Mirëpo, ky plan nuk ishte i bazuar në rrezik, për t'i audituar fushat ku ka nevojë më tepër, në mënyrë që të ndërmerren veprime për forcimin e kontrolleve të brendshme. Çështja e fundit është progresi në zbatimin e rekomandimeve nga viti paraprak, ku raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2019 të Bifurkacionit, ka rezultuar në 34 rekomandime kryesore. Deri në fund të auditimit për vitin 2020, 24 rekomandime janë zbatuar, 4 (katër) ishin në proces dhe 6 (gjashtë) nuk ishin adresuar ende. Ndërsa, për vitin 2020, ZKA-ja ka dhënë gjithsej 18 rekomandime të reja.

Kryesuesja falënderoi deputetin raportues dhe ua kaloi fjalën përfaqësuesve të kompanisë dhe pastaj deputetët do të kenë mundësi që të shtrojnë pyetjet e tyre.

Nazif Asllani, u.d. KE i kompanisë “Bifurkacioni”, tha se është ushtrues i detyrës prej 16 dhjetorit të vitit 2020 e deri më tani. Edhe unë edhe zyrtari i tashëm financiar, kemi qenë punëtorë të kamotshëm në Bifurkacion. Vetëm më lejoni t’ju informoj që prej këtij viti, kompania jonë ka kaluar në nivel qendror. Kjo është hera e dyte që auditohet kompania jonë. Ne do të ballafaqohemi me të gjeturat dhe do të bëjmë progres. Pa marrë parasysh se a do të jem në këtë pozitë, besoj që shumë shpejt do të rregullohen. Vetëm sa për informatë, zyrtarin për certifikim vetëm sa e kemi rregulluar dhe e kemi sistemuar në zyrën e vet me vendim. Të gjeturat tjera janë zakonisht financa dhe mosadresimi i saktë i problemeve. Por, sidoqoftë, ne jemi pajtuar me të dhënat e të gjeturave. Kemi pasur ndryshime edhe në staf dhe përbërje, prandaj edhe periudha kur është audituar, duhet mirëkuptim. Ne jemi pajtuar me auditorët dhe mund të diskutojmë për çdo gjë që keni për të pyetur. Këtë vit, auditorja jonë, vetëm e ka audituar shumicën e punëve, rreth 70%. Po shpresoj që brenda vitit, t’i përmirësojmë të gjeturat. Te borxhet është e vërtetë ajo që u tha, por situata e pandemisë e ka bërë punën e vet, ka edhe qytetarë që kanë paguar, por ka edhe të tjerë që nuk e kanë paguar. Ne jemi duke përgatitur regjistra dhe ata që nuk kanë bërë asnjë pagesë duhet ta kthejnë borxhin. Për çdo pyetje, jemi këtu.

Kryesuesja pyeti: A ka diçka për të shtuar nga përfaqësuesit e ZKA-së?

Arvita Zyferi, tha se vetëm u përmend që kompania ka opinion të kundërt dhe gabimet janë materiale. Jemi pajtuar me të gjeturat dhe i kemi diskutuar ato. Vlen të theksohet se është një

progres i mirë, sepse prej rekomandimeve të kaluara, 22 të tilla i kanë zbatuar, mirëpo që 8 rekomandime janë përsëritur, një fakt shqetësues. Këto kanë ndikuar që baza për opinion të jetë e kundërt. Në qoftë se ka diçka tjetër rreth të gjeturave, mund të përgjigjemi.

Kryesuesja hapi debatin dhe hapësirën për pyetje rreth raportit apo kompanisë.

Mirlinda Sadiku, tha se nuk është e vërtetë që kompania është në gjendje të mirë financiare. Kjo e argumentohet me mënyrën e faturimit të rregullt në vitin 2019, keni pasur të hyra rreth 2,170,000 €, ndërsa në vitin 2020, rreth 2,120,000€. Domethënë, vetëm rreth 42,000 euro në fitim. Është mangësia të shifrat, arsyeja se përse opinioni është i kundërt. Te prokurimi, ju e keni obligim ligjor që të keni plan të prokurimit. Sipas raportit rezulton që keni bërë kontrata pa plan të prokurimit. Nuk keni zyrtar certifikues dhe diçka shumë e rëndësishme që bordi nuk ka siguruar organogram dhe rregullore të brendshme. Unë nuk e di se si mund të funksionojë një kompani pa këto. Duke e pasur parasysh që keni pasur vetëm 40 mijë euro fitim, por keni hapësirë që të merrni edhe beneficione me vlerë rreth 4,700 euro për 11 muaj. Viti 2020 ka qenë sfidues, për shkak të pandemisë, ndërsa ju keni gjetur hapësirë t'i shpërndani vetes beneficione, në kundërshtim me Ligjin 03/87 për ndërmarrje publike. Një tjetër çështje me rëndësi është te konsumatori. Ligji që e ka bërë faljen e borxheve, a keni punuar që të krijoni një databazë me të dhënat e konsumatorëve apo jo? Sa janë borxhlinjtë ndaj kompanisë, cilat janë kompanitë që kanë më së shumti borxh dhe a ka Komuna e Ferizajt borxh ndaj juve? Është mirë të qartësohet edhe te projekti i quajtur “Bashkimi i Qytetit”, a ka pasur dëmtime ndaj rrjetit të ujësjellësit?

Nazif Asllani, tha se i pranon të gjitha të gjeturat e vitit 2019, pavarësisht që ai është emëruar në këtë detyrë më vonë. Te prokurimi publik, është e vërtetë që bëhet planifikimi i prokurimit, por specifikat tona të punës janë më ndryshe. Për shembull, një prej pikave është blerja e pompave të ujit. Të gjitha fshatrat e qytetit furnizohen me puse. Ata para neve e kanë paraparë një shumë të caktuar me një operator ekonomik, por në atë moment që është kryer ajo shumë, neve çdo ditë na paraqiten pengesa. Sot, duke u nisur rrugës janë djegur 2 pompa të 2 fshatrave. Një pompë e tillë kushton 2,000-3000 euro dhe sigurisht që zyrtari i prokurimit duhet të gjejë zgjidhje të pagesave për t'i blerë ato pompa. Ne e kemi edhe Kaçanikun, edhe Hanin e Elezit, nuk është paraparë saktësisht se sa lëndë djegëse shkojnë, pastaj varet edhe nga dimri, ka qenë më i gjatë këtë vit, prandaj ne është dashur të blejmë shtesë. E kemi trashëguar një mekanizëm shumë të vjetruar. Automjetet të gjitha janë të vjetra. Disa funksionojnë, disa jo. Shpesh po duhet edhe që të riparohen ato. Ne sivjet e kemi bërë prokurimin e ri, por i kemi rritur vlerat pikërisht për këto probleme. Së bashku me kompanitë tjera të ujësjellësit e kemi paraparë një organogram gati të njëjtë për të gjitha ndërmarrjet, por bordet nuk e kanë miratuar ende. Shtatë kompani të ujit e kemi të ngjashëm, po shpresoj që shumë shpejt do të miratohet nga bordi. Kompensimet i kemi trashëguar, tani me rekomandim të auditorit i kemi ndaluar menjëherë. Por, asnjë kompensim tjetër, përpos të një komisioni, nuk e kanë bordet. Te konsumatorët, prej 35.000 konsumatorëve, mund të them se jemi një nga kompanitë më të mira në Kosovë për këtë aspekt, sepse kemi lidhur kontrata me konsumatorët, por normal që ka raste ku nuk mund të kyçet. Problemet zakonisht janë te konsumatorët që sapo kanë blerë banesa, sepse nuk po janë të pranishëm në Kosovë. Kemi lidhur shumë kontrata me qytetarë, tani si shtesë edhe Hani i Elezit. Te bashkimi i qytetit, çdo projekt që bëhet në qytet, neve na shkakton telashe. Sidomos tani, gjatë ndërtimit, ne iu shpjegojmë të gjithëve që duhet të kenë kujdes dhe të na lajmërojnë, sepse mund të dëmtojnë rrjetin. Sidomos, tani me një hov të zhvillimit të ndërtimitarisë, neve na shkakton edhe humbje

të ujit deri në intervenim. Ferizajn, me këtë kapacitet, me 170 litra për sekondë, për ujë të pijshëm, është e pamundur ta mbulojmë. Ferizaj nuk ka penda, e kemi vetëm ujin nga lumi dhe është problem menaxhimi i duhur i ujit. Të gjitha këto ia kemi paraqitur Qeverisë. Te pagesat nga komunat, vetëm Ferizaj ka vonesa, madje e kam takuar drejtorin e Arsimit dhe ia kam tërhequr vërejtjen e fundit për të kryer pagesat, pasi që ka një kohë të gjatë që nuk i kanë kryer këto pagesa. Përndryshe, Komuna e Kaçanikut dhe Hanit të Elezit janë tepër të përpiktë. Mund të përdorim edhe me thesar, por meqë jemi të një qytetit, janë zotuar që do t'i kryejnë obligimet. Të vetmit donatorë i kemi Qeverinë e Kosovës dhe atë të Zvicrës, por kemi nevojë urgjente që të shtojmë nivelin e ujit. Drejtoria e Arsimit, për momentin, është borxhliu më i madh.

Mentor Ugzmaili, tha se janë duke pritur që t'i kryejnë pagesat, përndryshe duhet të lidhim ndonjë kontratë apo me forma të tjera. Sa i përket thesarit apo përmbaruesit, ne po besojmë që brenda këtyre ditëve do të paguajnë borxhin, ashtu na kanë premtuar. Dallimi në mes vitit 2019 dhe 2020, te pjesa e faturimit, për shkak të mbylljes nga pandemia, mbi 3 muaj, inkasimi ka qenë më i dobët, për periudhën 2020.

Mirlinda Sadiku, tha se u bazua në raportin që edhe vetë ata e kanë nënshkruar, janë 2,120,792 euro për vitin 2020, ndërkaq në vitin 2019 janë 2,074,550 euro. Domethënë, në vitin 2020 ka më shumë. Si mendoni të dilni në fitim kur diferenca është vetëm 40 mijë euro? Bordi nuk po iu funksionon dhe pa një strategji, pa plan bashkë me komunat, si do ta nxirrni në fitim ndërmarrjen tuaj? Madje kur konsumatori ndëshkohet, por institucioni që e ka obligative mbetet në borxhe dhe ju thjesht i mirëkuptoni. Te konsumatori jeni më të ashpër, por te institucionet të butë. Kjo po tregon që në vitin 2020 keni inkasuar më shumë sesa në 2019, edhe pse ishte pandemi.

Mentor Ugzmaili, tha se faturimi ka qenë i planifikuar nga janari, por pastaj pas muajit qershor, kemi inkasuar më shumë. Sa i përket sesi do të jemi në fitim, vetëm në muajin e kaluar kemi qenë shumë mirë dhe fitimet janë rritur, sidomos këta muajt e verës. Pra, jemi duke i bërë presion edhe drejtorisë, jemi të detyruar që të shkojmë ose me thesar ose me përmbarues, në qoftë se nuk e kryejnë pagesën.

Nazif Asllani, tha se ne planifikojmë që në vitin 2021 të rritet inkasimi, pasi që është e vetmja mënyrë që ne mund të jemi në fitim. Edhe në vitin e kaluar kemi qenë në rritje, nuk është shumë e madhe, por e kënaqshme deri diku. Më vjen mirë që qytetarët janë vetëdijesuar, pasi që po i kryejnë obligimet me rregull dhe çdo ditë po shkon duke u bërë edhe më mirë. Ne tani kemi kaluar në nivel qendror dhe më nuk ka presion nga komuna dhe jemi më të lirë. Tani ua kemi bërë të qartë që më nuk është njëjtë. Shpresoj dhe jam i bindur që këtë muaj do ta kryejnë në masë të madhe.

Hajdar Beqa, tha se sipas informacioneve të tij, vetëm vitin e kaluar ka ndryshuar statusi i ndërmarrjes, nga ajo lokale në qendrore dhe e dimë që ka vështirësitë e veta, ndryshimi i aksionarit. Sa i përket raportit të auditorit, edhe ju e sqaruat dhe e pranuat. Më tej, tha se 34 të gjetura, 22 i keni zbatuar dhe të tjerat do t'i zbatoni. Mua më intereson se a keni plan të veprimit për zbatim të rekomandimeve. Nuk e kuptova mirë te trajtimi i faljes së borxheve, nuk i takon vetëm drejtorit, por të gjithëve aty, pasi që po dihet që bordi mbikëqyr, ndërkaq menaxhmenti vepron. Nuk e kuptova, pse është bërë trajtim jo i duhur? Më intereson ta di sa

për qind e keni inkasimin, pasi e di që do ta rrisni në vitet në vijim. Praktikojeni përmbaruesin, pasi që ju nevojitet. Si ndërmarrje, a veproni në fitim operativ dhe a ka ndryshuar gjendja juaj, pasi kaluat në nivelin qendror? Si ndërmarrje, a keni ngritur ndonjë çështje që është e domosdoshme për ofrimin e shërbimeve nga Lepenci, a keni informata që janë bërë disa raporte nga Banka Botërore rreth kësaj?

Nazif Asllani, tha se planin e veprimit për zbatimin e rekomandimit vetëm e kemi përgatitur së bashku me zyrtarët financiarë dhe auditorin e brendshme. Përmbarues kemi pasur më herët shumë, por shkak i pandemisë e kemi ndërprerë. Në vitin 2016-2017, kemi pasur goxha shumë raste. Me të vërtetë, disa edhe e meritojnë, por ne normalisht që i respektojmë rregullat ku qortohen me vërejtje, pastaj me përmbarues. I kemi proceduar 7-8 raste tani. Përkujdesemi që të mos procedohen rastet sociale dhe jemi të kujdesshëm në këtë aspekt. Sa i përket pendës së Lepencit, e kemi diskutuar përfundimin e projektit nga komunat dhe Qeveria, por vlera më e madhe është te pjesa e shpronësimeve, por ajo është e vetmja zgjidhje për qytetet Ferizaj, Viti, Shtime. Këto janë problemet që po ballafaqohemi, ndërsa sa i përket përqindjes së inkasimit, jemi duke e rritur për çdo muaj. Edhe ne kemi punuar me staf të reduktuar, përgjatë pandemisë kemi pasur pak staf dhe pak inkasantë, por me kohë i kemi rritur pastaj. Bordi i kontrollon raportimet që i bëjmë ne. Për procesin se si jemi duke shkuar, sa borxh është hequr çdo muaj, i raportojmë bordit.

Arvita Zyferi, tha se jo vetëm këtë rekomandim, por çdo rekomandim e adresojmë te organi mbikëqyrës i çdo institucioni, sikur te çdo organizatë buxhetore që e dorëzojmë te ministri, çdo rekomandim mund ta veprojë ministri, mirëpo është përgjegjës që të mbikëqyrë procesin e raportimit financiar, në të njëjtin rast, çdo rekomandim në ndërmarrje publike i adresohet bordit, sepse është organ mbikëqyrës i raportimit financiar të kompanisë.

Hajdar Beqa, tha se sa e kuptoj, te pjesa e faljes së borxheve, nuk e ka menaxhuar mirë këtë situatë. E lexova më herët, por mendoj që është teknike. Ata duhet që së bashku me menaxhmentin të bëjnë planin e biznesit. Normalisht, që ka përgjegjësi Bordi i Drejtorëve, në këtë rast.

Eman Rrahmani, tha se shqetësues është fakti që opinioni është i kundërt dhe pasqyrat financiare nuk paraqesin një pamje të drejtë. Mua më pengoj arsyetimi te prokurimi, kur rregullat dhe ligjet e shpenzimit të parasë publike janë shumë të qarta. Ne e kuptojmë që ka nevojë kur ka ndonjë urgjencë. Por, janë disa shkelje që nuk mund të bëhen. Kur kemi blerje me negocim e jo me prokurim, atëherë askush prej neve nuk mund të besojë që ai që ka negociuar nuk e ka rritur çmimin e shërbimit. Për këtë arsye, janë ligjet që duhen respektuar. Këtu ka përgjegjësi ish-zyrtari financiar, sepse nuk i ka paraqitur mirë dhe me rregulla të kontabilitetit, ju duhet t'i adresoni këto. Kur është opinioni i kundërt, ne nuk mund të bëjmë as diskutime të sakta. Ajo çka do të kërkoja është respektimi i rregullave dhe ligjeve të përkufizuara për shpenzimin e parasë publike. Si këshillë, nuk është çështje e mirë që t'i zëvendësoni punën e dikujt tjetër, sepse nuk është menaxhim i duhur dhe ka humbje financiare.

Nazif Asllani, tha se është zgjedhur më 16 dhjetor 2020 dhe foli para periudhës kur ka qenë kryeshef, isha menaxher i burimeve njerëzore. Normalisht, pajtohem me ju, por fola vetëm për këtë periudhë sa nuk isha kryeshef. Ne jemi pajtuar me të gjeturat dhe duhet respektuar

ligji dhe të gjitha rregullat. Natyra e punës tonë e kërkon një prokurim të paplanifikuar, sepse ju tregova shembujt me pompat e ujit, në qoftë se ndodh edhe në ora 12 të natës, mund të na duhet ajo pompë.

Albana Bytyçi, pyeti: Prej dhjetorit deri më sot e kanë zbatuar një rekomandim, domethënë një rekomandim për gjashtë muaj, si mendoni që do t'ia dilni me të gjithë ato rekomandime? Çka keni ndërmarrë për të zbatuar këto të gjetura dhe si e mendoni zgjidhjen e planifikuar për furnizim me ujë për të gjithë fshatrat? Po shihet që ka shumë parregullsi, por jam e interesuar te rekomandimet e pazbatuara, si do t'ia dilni?

Nazif Asllani, u përgjigj dhe tha se menjëherë pas ardhjes në këtë pozitë, auditimi ka zgjatur 5-6 muaj në ndërmarrje. Raporti sapo na ka ardhur dhe normalisht që ne nuk kemi mundur që t'i zbatojmë rekomandimet e tjera, sepse është një periudhë shumë e shkurtër. Atë që unë kisha mundësi, e kam rregulluar menjëherë. Zyrtarin certifikues e kemi emëruar menjëherë. Sa i përket furnizimit me ujë në fshatra, me këto kapacitete që i kemi, nuk kemi mundësi që mbulojmë më shumë. Prandaj, duhet që rezervuarat të shtohen, por prapë nuk do të jenë të bollshme për qytetin. Pra, pa u rregulluar Lepenci, nuk do të kemi sukses të madh. Prej momentit që kemi kaluar në nivel qendror, ka ndryshuar situata pozitivisht.

Enver Haliti, pyeti: Sa borxh ka saktësisht Komuna e Ferizajt? Përqindja e inkasimit në raport me faturimin, nuk e patëm si vlerë, në qoftë se e keni, ose në qoftë se jo, atëherë na dërgoni me email. A ka pasur probleme të shkaktuara në rrjet nga projekti "Bashkimi i Qytetit"? Në qoftë se ju kanë shkaktuar dëme, duhet ta padisni komunën dhe kompaninë kontraktuese.

Nazif Asllani, tha se drejtori i inxhinierisë është duke u marrë me përpilimin e shifrës së dëmeve të shkaktuara nga ai projekt. Jemi duke e përgatitur, kur të përfundohet mund t'ua dërgojmë edhe juve. Shkalla e inkasimit në 6 muajt e fundit, deri në 80% i kemi arritur për këtë vit, për shifrat e sakta nuk i kam marrë shënimet, por po flas për këtë 6 muaj në 2021. Është rritur edhe shkalla e inkasimit, faturimit dhe rreth 1300 konsumatorë të rinj janë shtuar brenda kësaj periudhe. Vetëm Drejtoria e Arsimit e Komunës së Ferizajt i ka borxh ndërmarrjes sonë mbi 300,000 euro, që gjashtë muaj nuk kanë paguar asnjë faturë. Kemi biseduar me drejtorin, që t'u tregojmë se sa kanë borxh dhe duhet që ta paguajnë.

Mirlinda Sadiku, tha se kjo nuk është e drejtë, sepse po kursehet institucioni, por jo qytetarët. Nuk duhet të kursehen.

Fadil Nura, tha se dallimi në mes institucioneve, ku shkollohen fëmijët dhe qytetarëve, ka dallim substancial. Normalisht, që institucionet mund të kenë pagesa, por besoj që do ta shlyejnë këtë borxh. Pa u bërë projektet e mëdha është problem që të furnizohen të gjitha fshatrat pa ato investime. Keni probleme shpesh edhe me inkasim, duhet të punoni në këtë drejtim. Problemi i banesave kolektive, për shkak të kryqeve, ju duhet të bëni një bashkëpunim me komunën, që të kryhen kontratat gjatë procedurave fillestare, kur bëhet lëshimi i lejes nga komuna etj. Sa i përket projektit në Ferizaj, është evropian dhe i paparë në Kosovë më herët.

Nazif Asllani, tha se bordi i përkohshëm është zgjedhur nga Qeveria Hoti, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, tanimë është drejtori. Këtij bordi i ka skaduar mandati më 7 qershor

dhe nuk ka më mandat. Shpresojmë që shumë shpejt do të emërohet bordi i ri. E kam marrë kompaninë me 64% humbje, tash e 6 muaj e kam sjellë në 58%. Fshatrat është problem që të mbulohen nga rrjeti i ujësjetillësit. Shumica e fshatrave në Kosovë nuk kanë qasje në rrjetin e ujësjetillësit. Gjysma e qytetit të Hanit të Elezit nuk furnizohet me ujë. Tani Qeveria e Kosovës dhe ajo e Zvicrës, do të ndërtojnë një fabrikë që do të na ndihmojë dhe do të furnizohet me ujë. Të gjithë ujësjetillësit në Kosovë e kanë problem pjesën e aseteve, duhet gjetur një zgjidhje. Te kontratat, pronari që vjen për të marrë lejen, normalisht që vjen, por ne e vendosim një ujëmatës në tërë objektin, por pastaj kur shiten banesat dhe ndërrohet pronësia, është më ndryshe. Punimet kanë ndikuar në rrjet, por me zhvillimin tejet të madh të qytetit, është e pamundur të mbulojmë tërë qytetin.

Kryesuesja i falënderoi të ftuarit për pjesëmarrjen dhe pastaj KMFP vazhdoi me shqyrtimin e raportit.

Enver Haliti, tha se duke e marrë parasysh që ky menaxhment është i ri, ashtu siç u pajtua edhe komisioni, janë vetëm ushtrues detyre gati në të gjitha pozitat. Raporti i auditimit ka të bëjë me menaxhmentin e kaluar dhe bordin e kaluar. Pra, po të ishin ata në pozitat e njëjta, normalisht që do të rekomandonim shkarkimin e atij bordit, për shkak të performancës së dobët. Ne, si komision, nëse anëtarët kanë të gjetura specifike, atëherë mund të dalin si rekomandime nga komisioni, mirëpo unë mendoj që nuk është e nevojshme që të dërgohet në seancë plenare ky raport.

Përfundim

Komisioni vendosi njëzëri që raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Kompanisë Rajonale “Bifurkacioni” për vitin 2020, të mos dërgohet në seancë plenare.

Komisioni vendosi që të diskutojë për pikën e gjashtë të rendit të ditës, të propozuar nga deputeti Enver Haliti, para pikës së katërt të rendit të ditës, për shkak të vonësës së ardhjes së ministres Hajdari.

4. Rekomandim/kërkesë për Zyrën Kombëtare të Auditimit, për auditim të performancës të audituar për projektin “Bashkimi i Qytetit” në Komunën e Ferizajt

Enver Haliti, tha se kjo kërkesë vjen si rezultat i një tentimi të vitit të kaluar, ku para këtij viti kam kërkuar që të jetë pjesë e planit edhe auditimi i projektit në Komunën e Ferizajt apo projektit “Bashkimi i Qytetit”, që është bërë në bazë të një kontrate dyvjeçare. Ajo është lidhur më 17.9.2018, e cila ka pasur afat dyvjeçar. Siç e shihni, edhe pse jemi në vitin 2021, ky projekt ende nuk ka përfunduar brenda afatit të paraparë kohor. Tash e shoh të arsyeshme që ne si komision t’i rekomandojmë ZKA-së, që të ketë në plan vjetor edhe auditimin e këtij projekti, i cili kap vlerën e rreth 4 milionë euro. Procedurat janë kryer nga Komuna e Ferizajt, ndërkaq projekti është financuar nga Ministria e Financave. Për këtë kërkoj që të përkrahet nga kolegët, që të votohet dhe të shkojë si rekomandim. E pashë që në diskutimin paraprak, kryeshefi hezitonte që të jepte shifra, por janë ndoshta me milionë euro dëme që janë bërë në rrjetin e ujësjetillësit nga realizimi i këtyre punimeve. Mendoj që ka vlerë të madhe dhe duhet që auditohet dhe të kemi një raport të saktë nga auditorët.

Hajdar Beqa, tha se në parim çdo auditim është diçka e mirë, por ai mendon se në planin e vitit 2021 do të jetë edhe auditimi i Komunës së Ferizajt, ku hyn edhe projekti në fjalë. Besoj që kur e auditon tërë komunën, do ta auditojë edhe projektin me vlerën më të lartë kapitale. Mendoj se e gjithë kjo është një gjë politike, veprim politik, sidomos tani para fushatës së zgjedhjeve lokale.

Arvita Zyferi, tha se projektet e mëdha kapitale janë gjithmonë pjesë e planit të auditimi për komunat. Gjatë auditimit të komunës sigurisht që do të auditohet edhe ky projekt. Mirëpo, nëse dëshironi auditim të performancës, ju mund të dërgoni një kërkesë zyrtare në ZKA, me specifikat që i shihni të arsyeshme. Por, në aspektin financiar, kjo sigurisht që do të auditohet në kuadër të Komunës së Ferizajt.

Enver Haliti, tha se kjo është arsyeja se përse ai po e dorëzon me shkrim këtë kërkesë. Pasi që e shoh të arsyeshme, që të shkojë si rekomandim nga komisioni, që të kryhet një raport i performancës për këtë projekt. Në raportin për Komunën e Ferizajt nuk është që është përfshirë ai projekt. Neve na intereson performanca e këtij projekti dhe e di që ka pasur shkelje të mëdha të tenderimit, pagesave, bashkimit të kodeve buxhetore etj. Në një asnjë kod buxhetor nuk ka ndonjë emërtim si “Bashkimi i Qytetit”. Unë e di, sepse jam marrë me këtë një kohë të gjatë. Kemi kërkuar edhe raportim në Kuvendin Komunal, por kryetari nuk është paraqitur. Tingëllon afër fushatës, por unë kam një vit që e kërkoj këtë.

Hajdar Beqa, tha se ai e mbështet këtë kërkesë të deputetit Haliti, në qoftë se ky projekt nuk do të përfshihet në planin vjetor të auditimit. Edhe në këtë moment besoj që vetëm janë duke e kryer auditimin e komunave, por të presim raportin e auditorit, në qoftë se nuk është përfshirë, atëherë të gjithë do ta mbështesim këtë nismë. Në qoftë se kjo kalon në votim, unë as nuk marrë pjesë në votim, madje mund të mos e bëjë as kuorumin.

Fadil Nura, tha se pajtohet plotësisht me deputetin Beqa. Kjo po i bie që ne po ndërhyjmë në punën e ZKA-së, në planet e tyre të auditimi, me kërkesa të tilla specifike. Kur vetëm është caktuar data e zgjedhjeve lokale, kësaj po i vjen era politikë. Mandatin e keni 4 vjet, mos u ngutni, të gjitha raportet do të vijnë me kohë. Kush ka përvojë, e di që gjatë prokurimit e ka të lejuar me ligj 10%, madje BE-ja lejon deri në 20% të punëve të parapara. Nuk janë dëshmi këto që po i thua ti. ZKA-ja e ka përgjegjësinë e vet dhe sigurisht që do ta auditojë atë projekt, do ta analizojmë së bashku. Unë ua uroj qytetarëve të Ferizajt atë projekt, sepse e tërë Kosova po mburret me atë projekt. Është vizualisht evropian, por kur e njoh kryetarin e komunës, nuk besoj që e ka bërë ndonjë lëshim.

Eman Rrahmani, tha se nuk është në rregull që të jepen përfundime të tilla, që po ndërhyjmë në punën e ZKA-së. Ne e kemi në mandat që mund t'i kërkojmë atyre auditimin e një projekti apo organizata buxhetore. Kjo kërkesë do të duhej të mbështetej edhe nga ju, meqë jeni kaq të bindur që projekti është i pastër. Është mirë që të kërkohej një auditim i performancës.

Fadil Nura, theksoi se nuk tha që ndërhy në punën profesionale të ZKA-së, por në momentin që është ad-hoc, auditimi i një projekti, është ndërhyrje në planin e auditimit dhe si rrjedhojë është një ndërhyrje para zgjedhjeve lokale. Le të ndodhë ai auditim, por brenda afateve dhe mundësive të auditorëve, në vitin tjetër.

Hajdar Beqa, tha se në qoftë se vazhdon kështu, do ta lëshojë mbledhjen. Është bërë një auditim i plotë i Komunës së Ferizajt, do të përfshihet edhe ai auditim i projektit. Neve si PDK na imponohet që të lëshojmë mbledhjen.

Kryesuesja e hodhi në votim kërkesën e deputetit Haliti për auditimin e projektit “Bashkimi i Qytetit” në Komunën e Ferizajt. Kërkesa kaloi me 5 vota për dhe 1 kundër.

Përfundim

Komisioni vendosi, me shumicë votash, që rekomandimi i deputetit Haliti, t'i dërgohet ZKA-së, për auditimin e projektit “Bashkimi i Qytetit” në Komunën e Ferizajt.

Komisioni vendosi që të diskutojë për pikën e shtatë të rendit të ditës “Të ndryshme”, para pikës së katërt të rendit të ditës, për shkak të vonesës së ardhjes së ministres Hajdari dhe para pikës së pestë, për shkak të mosardhjes së përfaqësuesve të NP “Hortikultura”.

5. Të ndryshme

Kryesuesja i njoftoi deputetët, se është zgjedhur kompania audituese për auditimin e PVF-ve të subjekteve politike, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe komisionit i mbetet që në mbledhjet e radhës, të hedhë shortin, siç është paraparë edhe me Ligjin për financimin e subjekteve politike. Po ashtu, njoftohet komisioni se për auditim të PVF-ve të ZKA-së për vitin 2021, 2022 dhe 2023, kanë dështuar procedurat tenderuese, për shkak të mosinteresimit të operatorëve ekonomikë.

Përfundim

Komisioni vendosi njëzëri që hedhjen e shortit për auditimin e raporteve financiare dhe atyre të deklarimit financiar të subjekteve politike për vitet 2018, 2019, 2020, ta bëjë në mbledhjen e radhës, më datë 13.7.2021.

6. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ndërmarrjes Publike Lokale “Hortikultura” sh.a. për vitin 2020. Të ftuar, kryetari i Bordit dhe kryeshefi ekzekutiv

Kryesuesja, tha se as sot përfaqësuesit e Hortikulturës nuk janë të pranishëm, por ne si kolegë jemi marrë vesh që, në qoftë se mungojnë edhe sot, ne do ta shqyrtojmë raportin e tyre pa prezencën e tyre ose edhe ta dërgojmë për shqyrtim në seancë. Po ia kaloj fjalën deputetes raportuese.

Albana Bytyçi, tha se meqenëse nuk janë përfaqësuesit këtu, nëse jeni të pajtimit do të vazhdojë në pika të shkurtra dhe do të bëjë pyetje. Propozimit im është që ky raport të dorëzohet nga komisioni për në seance plenare. Kam përgatitur edhe disa rekomandime. Ne mundemi që raporti me këto rekomandime të adresohet për në seancë plenare. Lidhur me këtë, i ka tri rekomandime. Rekomandimet e propozuara ishin:1. Bordi i Drejtorëve të NP “Hortikultura” menjëherë të bëjë një analizë gjithëpërfshirëse të arsyeve, lidhur me të gjeturat

e raportit të auditimit. Pas analizës, Bordi menjëherë të krijojë një plan veprimi konkret që përfshin veprimet konkrete për adresimin e rekomandimeve, me theks të veçantë, rekomandimet që janë materiale dhe që kanë ndikuar në opinionin e auditimit. 2. Bordi i Drejtorëve të bëjë një rishikim të mirëfilltë të funksionimit të Departamentit të Kontabilitetit, Financave, duke vlerësuar përshtatshmërinë e stafit dhe përgatitjen profesionale dhe teknike, pasi që shumica e të gjeturave ndërlidhen me çështjet e kontabilitetit dhe kuptimin dhe zbatimin e dobët të standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar. Po ashtu, Bordi të sigurojë që programi i kontabilitetit dhe financave është rishikuar për të përmbushur kërkesat e standardeve të aplikueshme. 3. Bordi i Drejtorëve të raportojë te Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, për progresin e adresimit të rekomandimeve të ZKA-së dhe rekomandimeve të dala nga Komisioni.

Përfundim

Komisioni vendosi njëzëri që shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ndërmarrjes Publike Lokale "Hortikultura" sh.a. për vitin 2020, së bashku me rekomandimet e deputetes raportuese, të dërgohet për seancë plenare.

7. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin 2020

Albana Bytyçi, tha se pasi që deputetët e pozitës nuk dëshirojnë bashkëpunim, edhe ajo është e detyruar të largohet nga mbledhja.

Arta Bajraliu, tha se e ftuar në këtë mbledhje për të shqyrtuar të gjeturat e raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për vitin 2020, janë ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, znj. Rozeta Hajdari dhe stafi i saj. Për më tepër, do të na flasë deputeti raportues, Eman Rrahmani.

Eman Rrahmani, tha se ZKA ka bërë auditimin e pasqyrave financiare vjetore të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për vitin 2020, e cila ka opinion të pamodifikuar. Ky auditim përmban pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020. Sipas opinionit të ZKA-së, pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Baza për konkluzionin e pajtueshmërisë është kontrata në vlerë 1,286,691€ dhe aneks-kontrata në vlerë 128,223€, për projektin: "Ndërtimi i infrastrukturës për Parkun Industrial në Lumadh, ishte përcjellë me mangësi të ndryshme, duke filluar nga hartimi i projektit deri tek ekzekutimi i punimeve. E gjetura e dytë është se ishin bërë pagesa të parregullta në vlerë 122,738€, për të punësuarit me Marrëveshje të Brukselit. Te këto dy të gjetura, unë kam një pyetje për auditorin: cilat janë arsyet e të gjeturave që janë përsëritur nga viti 2019? Mirëpo, opinionin në këtë vit është i pamodifikuar, ndryshe nga viti i kaluar. Është mirë që të na shpjegoni se çfarë ka ndodhur në këtë pikë. Te theksimi i çështjes Pasuritë kapitale me vlerë mbi 1,000€, të prezantuar në nenin 19.1, në raportin vjetor financiar ishin të mbivlerësuar. Kjo për faktin se 7,882,045€, pasuri që ishin në kuadër të programit 23300, nuk ishin bartur pas ristrukturimit të Ministrisë së Zhvillimit

Ekonomik (MZHE). Po ashtu, pasuria ishte e nënvlerësuar për 923,265€, sepse 12 pagesa të realizuara gjatë vitit 2020, nga kategoria e investimeve kapitale, nuk ishin regjistruar në SIMFK, në mungesë të zyrtares së pasurisë. Kjo ishte shpalosur në PFV-të e ministrisë. Pasuritë jokatitale, me vlerë nën 1,000€, të prezantuara në nenin 19.2 në raportin vjetor financiar ishin të nënvlerësuar, sepse 17 pagesat e realizuara për blerjen e pajisjeve të ndryshme nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, në vlerë 10,065€, nuk ishin regjistruar në E-pasuri. Pas këshillës sonë, vlera e aseteve 913,000€ ishte regjistruar në regjistër (datë 23.04.2021). Ndërsa, për largim të aseteve që janë në pronësi të MZHE-së, ishte dorëzuar kërkesa në MF, mirëpo një gjë e tillë akoma nuk është implementuar. Çështja A1, që është e gjetur e re, këtë vit, mangësi në projektin: “Ndërtimi i infrastrukturës për Parkun Industrial në Lumadh”. Në nenin 52, paragrafi 3 i rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik, parasheh: “Për punë ose shërbime shtesë që nuk janë përfshirë në kontratën origjinale, që u nënshtrohen disa kushteve të caktuara, operatori ekonomik (OE) i njëjtë, ekzekuton shërbimet ose punët shtesë, që nuk mund të ndahen në mënyrë teknike ose ekonomike, megjithëse si të ndara janë tejet të nevojshme për kompletim, si dhe vlera nuk është më shumë se 10 % e vlerës së kontratës origjinale”. Bazuar në marrëveshjen e datës 16.7.2018, me Komunën e Vushtrrisë, MTI kishte lidhur kontratë (datë 25.3.2019), me një OE për projektin: “Ndërtimi i Infrastrukturës për Parkun Industrial në Lumadh” në vlerë 1,286,691€. Gjatë rishikimit të pagesave të realizuara në vitin 2020 dhe ekzaminimit fizik për këtë projekt janë vërejtur mangësitë si në vijim: Disa pozicione të përshkruara te pjesa II e dosjes së tenderit (përshkrimi i çmimeve), nuk ishin hartuar në harmoni me projektin ekzekutiv dhe po ashtu disa pozicione tjera, të parapara në projekt, nuk ishin hartuar sipas gjendjes reale të terrenit. Pas fillimeve të punimeve dhe vlerësimit të kushteve të terrenit, nga operatori ekonomik (OE) ishte paraqitur nevoja për realizimin e dy pozicioneve shtesë (Furnizimi, transporti dhe punimi i materialit mbushës guror dhe rrafshimi i nënbazës me ngjeshje), të cilat nuk ishin paraparë në kontratën bazë. Zyra e Prokurimit dhe sekretari kishin miratuar kërkesën e menaxherit të projektit dhe pas zhvillimit të procedurës së negociuar pa publikim, më datë 12.11.2019, ishte lidhur aneks-kontrata me OE-në, e njëjtë, në vlerë 128,223€. Nga rishikimi i pagesave të realizuara kemi vërejtur që sasi të realizuara të aneks-kontratës ishin në vlerë 240,756€, duke tejkaluar vlerën e sasive shtesë të parapara në ankesë-kontratë për 112,533€. Më tutje, lidhur me atë se a lejohen ndryshimet në kontratë gjatë ekzekutimit të kontratës, më datë 26.6.2020, KRPP, në ueb faqe kishte dhënë interpretim se “Kurdo që ndryshimi i kontratës zgjeron në mënyrë të konsiderueshme objektin e kontratës, me qëllim që të përfshihen më shumë sasi të furnizimeve, shërbimeve apo punëve shtesë, konsiderohet ndryshim thelbësor dhe rrjedhimisht nuk lejohet. Kur nevojat e autoritetit kontraktues nuk mund të plotësohen, pa bërë ndryshime thelbësore të kontratës, atëherë e vetmja alternativë është që të ndërpritet kontrata aktuale dhe të iniciohet procedurë e re e prokurimit.” Çështje tjetër e përsëritur përsëri në këtë vit, kompensimi i punonjësve pa vijueshmëri në punë. Rregullorja 05/2010 (neni 7) e shfuqizuar në gusht 2020, me hyrjen në fuqi të Rregullores (QRK) nr.12/2020 për orarin e punës dhe pushimet e zyrtarëve (neni 8), përcaktojnë se “Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtaret publikë janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik, nr. 06/39 të datës 22.7.2015, Qeveria e Kosovës ka miratuar konkluzionet e dakorduara të Marrëveshjes së Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, për realizimin e marrëveshjes së ashtuquajtur “Mbrojta civile”. Përmes këtij vendimi, MTI ka të angazhuar 25 punonjës të komunitetit serb, me qëllim të integritimit të tyre në sistemin e Republikës së Kosovës. Këta punonjës nuk kanë punuar asnjëherë për MTI që

nga viti 2016, kur edhe janë nënshkruar aktemërimet a tyre. Shpenzimi në total për pagat e këtyre të punësuarve për vitin 2020 ishte 122,738€, edhe pse për të njëjtit nuk ka dëshmi të vijimësisë në punë. Domethënë në këtë periudhë rreth 600,000 euro kanë shkuar më kot për kompensimin e punonjësve që nuk kanë ardhur kurrë në punë. Çështje e re në këtë raport është realizimi i shpenzimeve në mungesë të kontratës valide. Ministria e Administratës Publike, më datë 29.3.2017 kishte lidhur kontratë publike kornizë, me afat 36 muaj, me Telekomin e Kosovës për shërbimet telefonike mobile, internet, internet për GPRS, kablllo optike, shërbimet e telefonisë fikse, shërbimet e TV- kabllor. Më pas, MTI kishte lidhur marrëveshje direkt me PTK-në për shfrytëzimin e kësaj kontrate publike kornizë. Kjo marrëveshje kishte afat deri më 30.3.2020. Gjatë rishikimit të pagesave për shpenzimet e telefonisë fikse dhe mobile kemi vërejtur që MTI kishte realizuar pagesat për këto shërbime edhe pas skadimit të afatit të kontratës, më datë 31.3.2020. Pagesat totale të realizuara për periudhën prill - dhjetor ishin 17,473€. Çështje tjetër është tjetërsim i pasurisë pa miratimin paraprak nga MF. Gjetja, neni 9, paragrafi 2 i Rregullores së MF-së 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare të organizatave buxhetore, përcakton: “Për pasuritë kapitale të blera me fondet prej grantit qeveritar ose edhe me fonde donatorësh, para çdo tjetërsimi duhet të merret miratimi edhe nga Ministria e Financave”. Krahasimet tona të bëra ndërmjet regjistrit të përgjithshëm të aseteve me regjistrin e automjeteve që janë në përdorim (regjistër i menaxhuar nga njësia për menaxhim të automjeteve), rezulton se numri i automjeteve nuk përputhet. Pra, 8 (tetë) automjete, të cilat në vitin 2014 ishin shitur përmes procesit të ankandit publik për 18,100€, ende figurojnë në regjistrin kontabël të aseteve. Përveç kësaj, shitja e këtyre automjeteve nuk ishte bërë me miratim paraprak nga MF, siç kërkohet me Rregulloren nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare të organizatave buxhetore. Shitja e automjeteve ishte bërë në bazë të udhëzimit për ankand publik dhe nuk është dokumentuar kërkesa për miratim nga MF për shitjen e tyre dhe as kërkesa e adresuar në këtë institucion për largimin e këtyre automjeteve nga regjistri i pasurive. Çështja tjetër është mangësia në regjistrin kontabël të pasurisë, sipas nenit 6 i Rregullores së MF nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare të organizatave buxhetore, parasheh: “Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe të azhurnojë regjistrin e pasurive jofinanciare, që ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël”. Po ashtu, neni 22 thekson: “Të gjitha pasuritë jofinanciare kapitale dhe jo kapitale do t’i nënshtrohen normave të zhvlerësimit”. Ky nen i rregullores përcakton edhe normat e zhvlerësimit për secilin kategori të pasurive. Dy pagesa për blerje të pajisjeve për AMK (në vlerë 54,640€ dhe 26,050€) ishin regjistruar në SIMFK, me vlerë totale të faturës. Në kuadër të këtyre faturave figuronin lloje të ndryshme të pajisjeve dhe si rrjedhojë, zhvlerësimi i këtyre pasurive është aplikuar në vlerën totale si “pajisje tjera” dhe jo sipas normave të paracaktuara për çdo klasë të pasurive. Kjo ka ndodhur për shkak të kuptuarit jo të drejtë të kërkesave ligjore nga zyrtarët përgjegjës. Deri në fund të auditimit për vitin 2020, gjashtë rekomandime janë zbatuar, një ishte adresuar pjesërisht, tre nuk aplikohen më dhe dy nuk janë adresuar ende. Këto janë gjetjet e raportuara në këtë raport të ZKA-së. Po ashtu, besoj që për këtë raport nuk ka përgjegjësi ministria, por është mirë të na njoftoni për hapat e gjetjeve që duken edhe serioze. Ne kemi pritur që në këtë ministri do të ketë gjetje më të mëdha, por besoj që ZKA-ja do të na njoftojë për më shumë.

Rozeta Hajdari, ministre, tha se vetëm parku i biznesit ka pasur shumë të gjetura, por fokusi qëndron sot te ky raport. Unë do të përgjigjem për të gjitha të gjeturat që i përmendi edhe deputeti Rrahmani, por duke e ditur që ne nuk kemi qenë përgjegjës në vitin 2020, prapë

pajtohemi me të gjitha të gjeturat. Ne, ditëve në vijim, do ta kemi të gatshëm planin për të gjitha adresimet e çështjeve. Ne do të caktojmë një grup, i cili do të monitorojë zbatimin e planit të adresimit. Është e rëndësishme të mangësitë në raportimin financiar, të prezantuara, ku edhe unë pajtohem se përse ka një konkluzion si i pamodifikuar. Ministria i ka siguruar të gjitha masat që në vitin 2021 të jenë të gjitha raportimet financiare të pasqyrave financiare. Te çështja A1, mangësi në projektin: “Ndërtimi i infrastrukturës për Parkun Industrial në Lumadh”, vërtetë kjo e gjetur është brengosëse. Do ta trajtojmë me seriozitet dhe do të marrim masat që të mos tejkalohet vlera totale e projektit. Është e rëndësishme të ritheksohet që ditëve në vijim, unë ju njoftoj që nga fillimi ishte filluar, nuk ishin specifikuar termat e referencës dhe ky projekt me vlerë 1,286,691€, është vërtet për t’u shqetësuar. Ky projekt ka pasur terme të referencës të specifikuar. Disa pozicione të përshkruara tek pjesa II e dosjes së tenderit (përshkrimi i çmimeve), nuk ishin hartuar në harmoni me projektin ekzekutiv dhe po ashtu disa pozicione tjera të parapara në projekt nuk ishin hartuar sipas gjendjes reale të terrenit. Shtim i kostove që nuk janë paraparë me kontratë. Zyra e prokurimit dhe sekretari kishin miratuar kërkesën e menaxherit të projektit dhe pas zhvillimit të procedurës së negociuar pa publikim, pa shpallje publike dhe procedurë të hapur. Shuma e aneks-kontratës ka kaluar 20% e lejuar. Rreth 130,000€ brenda një dite i janë dhuruar operatorit ekonomik, ndoshta e keni vërejtur që s’ka asnjë përshkrim apo raportim se çfarë pune është kryer deri më tani. Kështu që në mënyrë që të sigurojmë sukses, mbetet të rishikojmë të gjitha zonat ekonomike industriale. Te këto rishikime do të jenë një mësim për të gjitha ministrinë, që në krijimin e zonave të reja ekonomike dhe adresimin e zonave që janë ndërtuar dhe po ndërtohen. Kështu që çdo zonë e re do të ketë një analizë të arsyeshmërisë dhe çdo miratim do të bëhet në koordinim me ligjin. Çdo punë shtesë do të hapet konkursi publik i hapur. Sa i përket çështjes së dytë, kompensim i punonjësve pa vijueshmëri në punë, MTI-ja apo MINT-ja, i është drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme edhe viteve të kaluara, edhe tash, që të gjejë lokacionin e këtyre punonjësve. Unë jam takuar dje me 2 nga përfaqësuesit e 25 punonjësve që duan të punojnë dhe të japin llogarinë te MINT. Kjo çështje na jep njoftimin që të gjithë qytetarët e vendit e pranojnë Republikën e Kosovës. Ne tani kemi përgjegjësi që t’i alokojmë këta zyrtarë së bashku me ministrin Sveçla. Çështja e tretë, realizimi i shpenzimeve në mungesë të kontratës valide, shpjegimi që ministria nga marsi i vitit 2020 nuk kishte pasur një kontratë publike me PTK-në, me operatorin “Vala”. Ne kemi qenë të shtyrë që në atë kohë të shkohet me një kontratë në vete dhe jo të presë kontratën e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ne tani do të shkojmë në harmoni me MPB-në. Te çështja e tjetërsimit të pasurisë, tani kemi edhe 4 vetura të shitjes apo ankandit që i përmbushin procedurat e kërkuara. Te çështja e katërt, mangësi në regjistrin kontabël të pasurisë, këto dy regjistrime do të bëhen sipas rekomandimeve të auditorëve, sepse ka një laborator mobil dhe statik. Kështu që me ligjin e ri për naftën, e kemi krijuar bazën për funksionalizimin e matjeve të naftës. Kemi një laborator statik, për para paketime, e cila është regjistruar si një aset. Te çështja C1, mangësi në inventarizim të pasurive jofinanciare, do të formojmë një komision, i cili do të bëjë regjistrimin në regjistrat kontabël, i cili do të mundësojë prezantimin e gjendjes së saktë të pasqyrave financiare si të plotë. Kemi edhe shumë të gjetura përpos këtyre që i kemi përmendur, sidomos te zonat ekonomike. Të gjitha këto do të rishikohen dhe riadresohen pas analizës dhe termave të rinj të referencës.

Arvita Zyferi, tha se kërkuan sqarime te baza për konkluzion. Rreth vlerave të pagesave të parregullta, ZKA-ja sivjet ka implementuar një projekt, i cili është financuar nga BE-ja, ku ne për herë të parë japim një konkluzion mbi pajtueshmërinë. Deri më tani i kemi raportuar të

gjitha, pajtueshmërinë dhe mospajtueshmërinë, lidhur me të gjeturat, ndërsa tash i kemi vendosur çështjet të cilat janë materiale, por në aspektin e pajtueshmërisë i kemi vendosur te baza për konkluzion. Këto janë më të rënda sesa çështjet tjera. Këto pagesa të rregullta kanë ndikuar në konkluzionin e pajtueshmërisë së bashku me kontratën e 1,200,000 eurove. Ne e kemi një metodologji që e zbatojmë në bazë të manualeve të auditimit dhe pajtueshmërisë. Mbi bazën e shpenzimeve vjetore të një ministrie do të tregoj pastaj sa do të jetë gabimi i tolerueshëm në atë organizatë dhe çdo pagesë e parregullt e madhe ndikon në konkluzion. Të gjitha pagesat e parregullta paraqiten në raport, vetëm se nuk riradhiten te konkluzioni, por në pjesën tjetër. Ne nuk mund të paraqesim të gjitha gjeturat, pasi që mostra mund të jetë si shembull i 100,000 pagesave. Ne nuk mund t'i auditojmë ato, të gjitha, por në bazë të mostrës.

Eman Rrahmani, tha se kemi edhe dy çështje të theksuara që nuk kanë ndikuar në opinionin e auditimit. Në qoftë se ka një limit që ndikon te klasifikimi i opinionit, mendoj se ka shumë rëndësi që në përmbajtje të jenë të gjitha të theksuara. Njëra e gjetur është që 5 vjet, të tjerat janë të reja. Dua ta falënderoj ministren për angazhimin dhe kritikën, që është dashur të auditohet edhe më shumë, shpresojmë që të mos përsëriten këto të gjetura.

Arvita Zyferi, tha se ka çështje që nuk janë varur nga ministria. Shembull ku pasuria ishte mbivlerësuar për 7 milionë euro, por ka ndodhur për shkak se kur është bërë ristrukturimi, këto nuk janë bartur në regjistrat e MZHE-së, por kanë mbetur në regjistrat e MTI-së dhe ne kemi parë shkresa që këta regjistra të barten në PVF-të e MZHE-së. MTI e ka bërë sqarimin e pasqyrës së saktë. Obligimet e ministrisë i ka përfunduar me anë të procedurave. Vlera nuk është e saktë dhe e kemi dhënë arsyetimin se përse. Kjo është arsyeja se përse nuk ka ndikuar në opinion.

Rozeta Hajdari, mua më brengos shumë çështja A1, mangësi në projektin “Ndërtimi i infrastrukturës për Parkun Industrial në Lumadh”. Nëse qytetarët tanë e shohin këtë gjendje, kuptohet se çfarë është bërë në këtë projekt. Kur i shoh rekomandimet e auditorëve, shoh vetëm një shabllon se çfarë duhet të veprohet. Unë kam filluar të kërkoj përgjegjësit për këtë projekt dhe duhet të adresohen sipas ligjit. Kjo e gjetur është shumë brengosëse.

Arvita Zyferi, u përgjigj se nëpërmjet rekomandimeve të tyre nuk ndërhyjmë direkt në procedurat menaxheriale të një organizate buxhetore. Këto rekomandime janë vetëm sinjale që u dërgohen menaxhmenteve dhe ne nuk hyjmë në specifika të vogla, sepse duhet vetë menaxhmenti t'i sqarojë me stafin e tij. Ne rekomandojmë, ndërkaq detajet ju mbeten juve.

Eman Rrahmani, pyeti përfaqësuesit e ZKA-së: A ka pasur çështje që kanë mundur të drejtohen në prokurori nga ky projekt, që e përmendi ministrja? A keni dhënë letër-menaxhmente për këtë raport të auditimit dhe në qoftë se po, cilat kanë qenë ato?

Arvita Zyferi, në ZKA është një departament, i cili merret me analizën e raporteve, pasi ato të publikohen. Ka raste kur edhe gjatë auditimit sinjalizohet ndonjë rast ku ka mashtrime. Ne nuk kemi autoritet që të shkojmë më tutje, por vetëm e njoftojmë Zyrën e Hetuesisë rreth rastit, ku pastaj e analizojnë dhe e rishikojnë se cila prej të gjeturave ka elemente të mashtrimit dhe dërgohet në prokurori. Sa i përket letër-menaxhmentit, është një gjetje sa i

përket llogarive të arkëtueshme, nuk i kam detajet me vete, sepse ajo është vetëm për menaxhmentin e ministrisë.

Eman Rrahmani, tha se duhet dhënë vërejtje, sepse edhe auditori i përgjithshëm, kur ishte i pranishëm në mbledhje, për shkak se ka filluar një praktikë këtë vit me letër-menaxhmentet, e sa kam informacion viteve të kaluara nuk ka ndodhur. Kemi kërkuar që kur të na sillni raportet, t'i sillni bashkërisht edhe me këto letër-menaxhmente, për shkak se ato jepen zakonisht për kompanitë private, jo për institucionet publike.

Arvita Zyferi, tha se sa i përket letër-menaxhmenteve, ajo është një praktikë që nuk ndodh vetëm te ne, por është me standarde, ku specifikohet se secila e gjetur që nuk e kalon nivelin e të rëndësishmeve apo nivelin e rivalitetit, ajo mund të mos raportohet në raport. Për shkak se janë disa gjetje që e humbin rëndësinë edhe të gjetjeve të mëdha, në qoftë se raportohen njëkohësisht. Për këtë arsye i raportohen direkt menaxhmentit. Në qoftë se përsëriten edhe vitin e ardhshëm, atëherë vendoset në raport.

Eman Rrahmani, iu përgjigj se kjo është plotësisht praktikë dhe standard i auditimit dhe që praktikohet. Por, siç thashë, zakonisht u dërgohen kompanive private. Ajo që na intereson, është se kjo praktikë ka ndodhur tani për herë të parë, mund të jetë edhe gabim, por në secilin raport, ju duhet të na dërgoni edhe letër-menaxhmentet.

Mirlinda Sadiku, tha se ministrja vetëm ka konstatuar të gjeturat dhe problemet në ministri. Ajo pyeti ZKA-në, se në disa rekomandime të mëhershme keni thënë se zakonisht, aty ku dyshohet për të gjeturat, ju vendosni një flamur të kuq që adresohet pastaj në prokurori. Aq sa kemi parë, diku kanë qenë rreth 50 raste. Mirëpo kjo e gjetur është shqetësuese, ku vlera e parasë publike është rreth 730,000 euro. Kjo nuk është në harmoni me dispozitat ligjore. Gjithashtu, pyeti ministren: A ka shkelje të mëdha, që të bën të mendosh që t'i adresoni aty ku duhet? Më në fund po adresohen çështjet e punonjësve të komunitetit serb. Ju thatë se dy vetëm kanë shprehur gatishmërinë, po për 23 të tjerët, si qëndron puna? Rreth zonës ekonomike të Vitisë, është duke u ndërtuar afër rrugës kryesore, ka filluar në vitin 2016, me planifikim të mbarimit në 2018, por ende tash në 2021 nuk është funksionale.

Rozeta Hajdari, u përgjigj se sa i përket shkeljeve në zonat ekonomike, ende nuk dua të jap një deklaram, përderisa nuk janë vlerësuar. Janë sinjale që na janë dhënë, por para vlerësimeve zyrtare nuk mund të japim diçka finale. E kemi rregulluar me anë të termeve të referencës, ku të gjitha zonat ekonomike do të shikohen, por nuk do të mund që të gjithë të përfundojnë këtë vit. Në një prej zonave është kërkuar që të kryhet pagesa rreth 200,000 euro dhe ne nuk do të lëshojmë pagesat në nguti, pa ndonjë analizë. Sa i përket punonjësve të komunitetit serb, ata kanë shprehur vet gatishmërinë që të punojnë në ministri. Përpos 25 të punësuarve, ne i kemi edhe 2 departamente që nuk kanë hapësirë të mjaftueshme për punë.

Arvita Zyferi, tha se edhe më herët e përmendi që është Zyra e Hetuesisë, që merret me këto çështje dhe ne sigurisht kemi dhënë sinjalizim që kjo e gjetur dhe disa të tjera duhet të shkojnë në prokurori, mirëpo i mbetet atyre që të vlerësojnë se a ka elemente të mashtrimit dhe ta dërgojnë në prokurori.

Eman Rrahmani, pyeti ministren rreth punësimeve me kontrata mbi vepër, ku ata që kanë qenë të punësuar të rregullt, nuk kanë pasur hapësira të punojnë, sepse kanë angazhuar shumë kontrata mbi vepër. Me ligjin e prokurimit nuk ka të drejtë të angazhohen punonjës të tillë. A ka ende të punësuar me kontrata mbi vepër?

Rozeta Hajdari, tha se kemi gjetur mjaftueshëm zyrtarë me kontratë mbi vepër, por paraprakisht kemi bërë një analizë të të gjitha departamenteve dhe agjencive të MINT-it, dhe kemi gjetur shembuj, ku i vetmi zyrtar për teknologji dhe inovacion, është me kontratë mbi vepër. Këtë, për shembull, nuk mundemi që ta largojmë, por shikoj se kemi shumë probleme për të zgjidhur. Kemi trashëguar rreth 600 ankesa rreth markave tregtare të patrajuara. Praktika të tilla kemi në agjenci të ndryshme, ku nuk kemi pasur zyrtarë të mjaftueshëm ligjorë apo te fushat tjera dhe është dashur t'i transferojmë. Është dashur që edhe këta zyrtarë, me kontratë mbi vepër, t'i angazhojmë deri në zgjidhjen e problemit. Për shkak të buxhetit të kufizuar, nuk janë paraparë shërbyes civilë. Ne do ta zgjidhim këto problem. Për mua janë të rëndësishme ato 600 ankesat dhe më pak të rëndësishme pjesa e të punësuarve me kontratë mbi vepër. Do të respektojmë ligjin e ri të prokurimit dhe besoj që MF do të shohë që neve na nevojiten zyrtarë të tjerë që duhet punësuar.

Kryesuesja pyeti deputetët: A ka ende ndonjë diskutim apo pyetje rreth këtij raporti?

Përfundim

Komisioni vendosi njëzëri që shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë të Tregtisë dhe Industrisë, për vitin 2020, të mos dërgohet në seancë plenare.

Mbledhja e radhës u vendos të mbahet më 13 korrik 2021, me fillim nga ora 10:00.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Arta Bajraliu,
Nënkryetare e parë e Komisionit
